



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



# Rregullore për ndarjen e subvencioneve

---

---

**FERIZAJ,  
SHTATOR .2012**

*Në bazë të nenit 12 pika c, e Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43 pika 3 e 4 Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02- Shpenzimi i Parave Publike dhe neni 28 paragrafi 1 pika (1), dhe neni 79 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Ferizajt, miratoi :*

***Rregulloren  
për  
ndarjen e Subvencioneve***

**1. Dispozitatat e përgjithëshme**

**Qëllimi**

**Neni 1.**

- 1.1 Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve buxhetore – fondi nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere për ndihmë momentale, entiteteve publike dhe jopublike.
- 1.2 Mbështetur në fondin e miratuar për Subvencioneve dhe Transfereve për vitin aktual, Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndan mjete financiare - ndihmë momentale ( ndihmë e menjëhershme) për entitetet publike dhe jopublike sipas kriterëve dhe procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.
- 1.3 Kryetari i Komunës lejon ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve për entitetet publike deri në shumën 10,000€. ndërsa për ato jopublike deri në shumën 1000€. Për çdo shumë më të lartë nga ajo e përcaktuar në këtë paragraf, për të dy rastet, vendos Kuvendi i Komunës.

**Neni 2.**

Ndihmë momentale sipas kësaj rregullore konsiderohet ndihma e menjëherëshme financiare që propozohet nga zyrtaret autorizues të programeve pas shqyrtimit të kërkesave dhe më pas miratimit të tyre nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.

### **Subvencionet për entitetet publike (institucionet jo fitimprurëse)**

#### **Neni 3.**

Ndihma momentale për entitete publike (institucionet jo fitimprurëse), përfshinë mbështetja që u ofrohet institucioneve kulturore, sportive, sociale e shëndetësore dhe jo qeveritare, ku nuk kërkohet asgjë specifike si kthim për këto pagesa.

#### **Neni 4.**

Kërkesat e entiteteve publike për Subvencione dhe Transfere duhet t'i drejtohen Kryetarit të Komunës përmes zyrës pritëse. Kërkesa duhet të jetë e kompletuar me dokumentacion mbështetës si: certifikata e regjistrimit, arsyetimi i kërkesës me prova të qarta dhe bindëse , numri i llogarisë bankare të entitetit publik.

#### **Neni 5.**

Kryetari i Komunës pas pranimit të kërkesës, e autorizon drejtorinë përkatëse respektivisht zyrtarin autorizues të programit, të shqyrtojë kërkesën dhe të jep mendimin profesional lidhur me kërkesën e parashtruar. Pas shqyrtimit të kërkesës nga ana e drejtorisë përkatëse, propozimi i dërgohet Kryetarit të Komunës për aprovim. Kryetari i aprovon kërkesat e justifikuara nga ana e drejtorisë përkatëse si propozime, të përcjellura me dokumentacionin i cili ka shërbyer për të arsyetuar kërkesën.

#### **Neni 6.**

Kryetari i Komunës merr vendim lidhur me kërkesën e entitetit publik deri në shumën e përcaktuar në nenin 1. Pragrafi 1.3 i kësaj rregullore. Nëse ndihma ka të bëjë me shumë më të madhe monetare, ajo duhet të procedohet përmes Kryetarit të Komunës në Komitetin për Politikë dhe Financa, përkatësisht në Kuvendin e Komunës për miratim.

## **Neni 7.**

Kryetari i Komunës mund të nënshkruaj marrëveshje zyrtare me përfaqësuesit e entiteteve publike për mënyrën e ofrimit të shërbimeve për palët e treta, në organizimin e manifestimeve kulturore me rastin e përvjetorëve të Komunës.

### ***Kriteret për financimin e projekteve.***

## **Neni 8.**

### ***8.1 Projektet nga fusha e kulturës duhet të plotësojnë këto kritere për subvencionim:***

8.1.1 Promovimet e vlerave (festivalet, koncertet, shenimet e datave historike dhe kulturore, simpoziumet, ekspozita dhe promovimi i librave të botuara),

8.1.2 Veprimtaria botuese,

8.1.3 Veprimtaria teatrale,

8.1.4 Veprimtaria filmike,

8.1.5 Artet pamore,

8.1.6 Trashëgimia kulturore,

8.1.7 Grupet artistike të Komunës së Ferizajt

### ***8.2 Projektet për çështje gjinore dhe integritet socio-kulturore.***

8.2.1 Projekti duhet të ketë vlera krijuese artistike,

8.2.2 Mbështetja e botimeve bëhet kryesisht për shpenzimet e shtypit,

8.2.3 Vlerësimi i veprimtarisë teatrale bëhet në bazë të kalkulimit të shpenzimeve të shfaqjeve teatrale,

8.2.4 Veprimtaria filmike vlerësohet sipas pozicioneve buxhetore të shpenzimeve të kalkuluara sipas zhanrit dhe skenarit për atë.

8.2.5 Në artet pamore më tepër subvencionohet botimi i katalogëve dhe kornizimi i pikturave,

### ***8.3 Subvencionimi në fushën e rinisë:***

8.3.1 projekte për fuqizimin e rinisë,

#### **8.4 Subvencionimi në fushën e sportit:**

8.4.1 Masivizimi i sportit për të rinjë,

8.4.2 Përkrahja e qendrueshme financiare për sportistët kulmor dhe klubet kualitative, të cilat mund të arrijnë rezultate të mira sportive,

8.4.3 Avancimin e organizimit në klubet sportive veçmas të femrave;

8.4.4 Partneritet me të gjitha organizatat sportive për implementimin e politikave zhvillimore afatshkurta dhe afatgjata,

8.4.5 Punë e vazhdueshme edukative dhe përkrahje në të gjitha drejtimet për tifozët e qytetit “Ujqit” të cilët janë pjesë përbërse e sportit,

#### **8.5 Kriteret për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të OJQ-ve, bazohen në:**

8.5.1 Promovimin e vullnetarizmit,

8.5.2 Integrimin e grupeve të marginalizuara,

8.5.3 Fuqizimi i organizatave rinore (seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjëve),

8.5.4 Edukimi joformal (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsimim) dhe

8.5.6 Punësimin e të rinjëve.

#### **Neni 9.**

përfituesit e subvencioneve të transfereve janë të obliguar që të sjellin dëshmi për shpenzimet si: faturat, lista me nënshkrime, ilustrime, rezultate etj; në të kundërtën mos arsyetimi rezulton në ndërprerjen e përkrahjes për kërkesa të reja poashtu administrata e komunës do të kërkojë kthimin e mjeteve nga përfituesi përmes procedurave ligjore.

**Subvencionet për entitetet jopublike në lëmin e Mirëqenies Sociale dhe asaj Emergjente ( familjet dhe individët).**

#### **Neni10.**

Në rastet urgjente të fatkeqësive të ndryshme natyrore, sëmundjes së rëndë të cilat kërkojnë mjekim të kushtueshëm, varfërisë së skajshme për familje apo individ të caktuar , Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara ndan ndihma momentale nga kategoria buxhetore për Subvencione dhe Transfere.

#### **Neni 11.**

Kryetari i Komunës lejon ndarjen e subvencioneve për personat dhe familjet në nevojë si ndihmë materiale për përkujdesje sociale dhe shëndetësore.

11.1 Ndhimja materiale nënkupton sigurimin e të hollave, ushqimit apo kompensimit e trajtimit të domosdoshëm mjekësor për një individ apo familje

11.2 Në projekte për monitorimin e punës me fëmijë.

11.3. Në projekte sezonale furnizim të skamnorëve me dru për ngrohje.

#### **Neni 12.**

Subvencionet dhe Transferet janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për institucionet jo profitabile, familjet dhe individët.

#### **Neni 13.**

*Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmës materiale:*

1. Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacionin mjekësor të specialistit,
2. Gjendja e rëndë ekonomike- familjare e vërtetuar me ndihmën e zyrtarëve social,
3. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve tjera dhe,
4. Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatëkeqësit elementare.

#### **Neni 14.**

Kërkesë për ndihmë momentale mund të paraqesin vetëm personat dhe familjet që janë banorë të përhershëm të Komunës së Ferizajt.

#### **Neni 15.**

Kompetent për shqyrtimin e kërkesave të individit apo të familjes (përveç nenit 8) janë komisionet e formuara nga Kryetari i Komunës për dy programet e strukturës buxhetore dhe ato: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Këto komisione kanë për detyrë shqyrtimin e kërkesave si dhe të propozojnë ndihmë momentale.

#### **Neni 16.**

Kërkesat e pakomletuara, komisionet nuk do ti procedojnë më tutje.

#### **Neni 17.**

Kërkesat që nuk plotësojnë kriteret për ndihmë momentale do të refuzohen nga Kryetari i Komunës me propozim të komisioneve.

#### **Neni 18.**

Shuma e ndihmës momentale për individët dhe familjet (përveç neni 8) propozohen nga komisionet;

#### **Neni 19.**

Komisionet specifikojnë listen e propozuar për ndihmë momentale dhe i dorëzojnë Kryetarit të Komunës i cili ka mundësi të ndryshoj para se të miratohet duke potencuar arsyetimin për ndryshime.

#### **Neni 20.**

Kërkesat duhet të shqyrtohen jo më larg se 30 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

#### **Subvencionet në lëmin e bujqësisë.**

#### **Neni 21.**

Ndarja e Subvencioneve në lëmin e Bujqësisë bëhet pas marrjes së Vendimit nga Kuvendi i Komunës për *Subvencionim* të kësaj dege të ekonomisë.

**21.1.** Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, nxjerrjen e vendimit për subvencionim në lëmin e bujqësisë duke bashkangjitur planin vjetor për subvencionim të hartuar nga Drejtoria e Bujqësisë së bashku me arsyeshmërinë.

#### **Neni 22.**

Kryetari i Komunës, mund të nënshkruaj marrëveshje zyrtare mbi formën e subvencionimit me përfituesit e entiteteve jopublike.

#### **Subvencionet në lëmin e Arsimit**

### Neni 23.

Ndarja e Subvencioneve në lëmin e Arsimit, konkretisht ndarja e bursave për student dhe subvencionimi i nxënësve me aftësi të kufizuar, i paraprinë Vendimi i Kuvendit të Komunës lidhur më këtë çështje.

23.1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës nxjerrren e vendimit për ndarjen e bursave, duke bashkangjitur edhe arsyeshmërinë.

### Neni 24.

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës.

### Neni 25.

Kjo rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

01.Nr. 66

10.9, 2012



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës